



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

KUVENDI I KOSOVËS

PROCESVERBAL
NGA PUNIMET E Mbledhjes së VIII-të të Seancës Plenare
MBAJTUR ME 13.06.2002 .

Mbledhja e Kuvendit të Kosovës filloi në ora 10:00 dhe në te mernin pjesë 75 Deputet.

Seancën Plenare e kryesoi dhe udhëheqi **Prof.Dr Fatmir Sejdiu** me Kryesin e punës nga këta anëtar të Kryesisë :

z. Xhavit Haliti anëtar,
z. Hydajet Hyseni anëtar,
z. Gojko Saviç anëtar
z.. Oliver Ivanović anëtar
zon.Claressa Surtees shefe e Sh.Juridik.

z. Prof dr. Fatmir Sejdiu hapi mbledhjen dhe i njoftoi deputetët se këtë mbledhje do ta udhëheqi,pasi Kryetari i Kuvendit të Kosovës z.Nexhat Daci ndodhet në një vizitë zyrtare në SHBA,me një grup deputetësh prej 29 vetash,propozoi

R e n d i n e d i t ë s

1. Debat mbi Rregulloren për krijimin e Agjensionit të Mirbesimit të Kosovës (AMK).
2. Emërimi i anëtarëve të ri të komisioneve
3. Të ndryshme.

Kryesusi i mbledhjes pyet deputetët se a pajtoheni me rendin e ditës,i cili është aprovuar pa vërrejtje nga ana e deputetëve.

Kryesuesi filloi me pikën e parë të rendit të ditës ,dhe pyet deputetët se Draftregulloren se a e keni marrë,dhe sigurisht ,Komisioni për buxhet,Qeveria i kanë çëndrimet e veta, prandaj ftoi Kryeministrin e Qeverisë që ta marri fjalën.

z. Bajram Rexhepi Kryeministri i Qeverisë së Kosovës theksoi:

Kjo Rregullore është propozuar para më tepër se një muaj nga Përfaqësuesi Special i KB në Kosovë, dhe iu është lënë në disponim Qeverisë që ta analizoi. Nga kjo z. Rexhepi ka parashtruar 10 vrejtje ,4 prej të cilave Administrata e UNMIK-UT I ka aprovuar kurse të tjerat kanë mbetur objekt diskutimi

- Propozimi I Qeverisë ishte që tre drejtorët që marin pjesë në bordin e Drejtorëve të jenë Ministra , për arsye se aty nuk ka qenë e precizuar, se përfaqësuesi serbë ai duhet të jetë i këtij niveli dhe kjo është pranuar .
- Kërkesa e miratuar ishte kyqja e Kryetarit BSDAK, si anëtar i bordit me qka është shtuar numri .
- Kërkesa ishte që njeri nga drejtorët e këtij bordi të jetë nënkryetarë,dhe nga radha e shqiptarëve e cila është pranuar .
- Është kërkuar që dy Kosovarë të jenë partnerë të barabartë gjatë procesit të operacionalizimit të procesit të privatizimit dhe të hartojnë Rregullorën për politikën operationale. Qeveria i ka propozuar z.Fatmir Sejdiun dhe Ahmet Shalën.

Kërkesat të cilat i ka bërë Qeveria e Kosovës janë pranuar dhe disa priten të planifikohen me politikat operationale .

Ai në fund preku edhe çështjen rreth grumbullimit të mjeteve të cilat gjatë procesit të privatizimit të mbeten në Bankat Kosovare ,dhe me to të investohen në ato fonde ku kanë perspektiv.

z. Ali Sadriu Ministër i Financave . Ai themelimin e kësaj Agjensie e vlersoi si ngjarje të rëndësishme për Kosovën, meqenëse dinamika në procesin e privatizimit do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve për vendet e reja të punës që do të ulë shkallën e papunësis në Kosovë.Të njejtin mendim e kishte edhe Deputeti **Fatmir Rexhepi.**

z. Bujar Dugolli Shef I Grupit Parlamentar të AAK-së.

Ai parashtrroi disa vrejtje në Draftin e propozuar ,duke përfshir zgjerimin e Bordit mbikëqyrës në të cilën do të përfshihen përfaqësuesit nga **Parlamenti, Oda Ekonomike dhe Sindikata** .Sipas tij është e papranueshme mos definimi i kësaj Agjensie.